

V E N D I M
Nr. 54, datë 5.9.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E DELEGACIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 29 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Në përbërjen e delegacioneve të përhershme të Kuvendit bëhen këto ndryshime:

1. Zoti Servet Pëllumbi caktohet kryetar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Unionin Ndërparlamentar në vend të deputetit Namik Dokle.

2. Deputetja Ermelinda Meksi caktohet kryetare e delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Parlamentin Europian në vend të deputetit Arben Malaj, ndërsa deputeti Marko Bello caktohet anëtar i këtij delegacioni në vend të deputetit Spartak Poçi.

3. Deputeti Et'ehm Ruka caktohet kryetar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së në vend të deputetit Kastriot Islami, ndërsa deputeti Taulant Dedja caktohet anëtar i këtij delegacioni në vend të zotit Ismail Lleshi.

4. Deputeti Fatmir Xhafa caktohet anëtar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të Bashkimit Ekonomik me Detin e Zi (PABSEC) në vend të deputetit Blendi Klosi.

5. Deputeti Maqo Lakrori caktohet anëtar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Iniciativa e Europës Qendrore (CEI) në vend të deputetit Viktor Doda.

6. Deputeti Gazmir Bizhga caktohet kryetar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të BEP-it në vend të deputetit Spartak Poçi.

7. Deputetët Namik Dokle dhe Vangjel Dule caktohen anëtarë të delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Këshillin e Europës në vend të deputetit Taulant Dedja dhe në vendin vakant të krijuar nga vdekja e deputetit Vasil Melo.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi